



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 640/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhimi i Turizmit, MSc, 120 ECTS, (maksimum 100 studentë për vit akademik).
- II. Akreditoohen programet e studimit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Programi Parashkollor, BA, 240 ECTS, (maksimum 100 studentë për vit akademik);
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS, (maksimum 100 studentë për vit akademik);
 - Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik);
 - Agrobiznes, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik).
- III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- IV. Obligohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

- V. Obligohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” që deri më datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Trashigimi Kulturore dhe Menaxhimi i Turizmit	MSc	120	Behxhet Brajshori, Gani Gjini, Nerimane Bajraktari-Gllogjani
2	Programi Parashkollor	BA	240	Vedat Bajrami, Elsev Brina, Samedin Krrabaj
3	Programi Fillor	BA	240	Ismet Temaj, Fahredin Shabani, Sebahajdin Cena
4	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	BSc	180	Ramë Vataj, Shukri Maxhuni, Muharrem Faiku
5	Agrobiznes	BSc	180	Isuf Lushi, Drita Krasniqi, Malush Mjaku

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” më 14.06.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Volker Frederking, Prof. Dr. Laura Bouriaud, Prof. Dr. Joachim Mueller.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë